



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:185698

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05681514

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr..../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Fatos Selmani, në çështjen penale kundër të pandehurës Sh..... H.... për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1496/23 të datës 30.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurës Sh..... H....., të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura,

Sh..... H....., i lindur më datë në S..., nga i ati B..., e ëma M..., mbiemri i vajzërisë J..., me vendbanim në rr. "T.... S....." në P....., studente e fakultetit ekonomik, e gjendjes se mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon numër te telefonit, me adresë elektronike e nacionalitetit Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e pa dënuar me parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Me datë, rreth orës, në rr."F..... A.....", pikërisht në Parkun "K....." në P....., pa autorizim posedon narkotikë, substanca psiktrope apo analoge në atë mënyre që, Policia e Kosovës, gjate angazhimit të tyre në festivalin "A..... 20..", hasin të pandehurën Sh..... jashtë vendit ku mbahej festivali dhe pas kontrollit nga zyrtarët policor tek e njëjta gjejnë substancë narkotike e mbështjellë në folje alumini e cila pas verifikimit me pajisjen NarTest NTX 2000, rezulton të jetë e llojit Marihuanë, në peshën neto 1.2 gram, të cilën e pandehura e kishte për konsum personal ku më pas substanca narkotike sekuestrohet,

-me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope apo analog nga neni 269 par. 2 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 269 të KPRK-së, 7, 8 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurës Sh..... H..... i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Në shumën prej 300,00 € (treqind euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e pandehura nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

E pandehura obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të pandehurës i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan ne peshë prej 1.2 gram.

Arsyetim.

Prokuroria Themelore në Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 06.06.2022 ka ngritur aktakuzë PP.nr.1496/23 kundër të pandehurës Sh..... H.... për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës e pandehura është deklaruar fajtores për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se: jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla de me vjen keq për rastin.

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPRK-se ngase aktakuza mbështetet ne këto prova: Raporti i oficerit Hasan Lajçi #3950 e dt. 18.07.2023; Deklarata e te pandehurës Sh..... B..... e

dhënë ne Stacionin Policor ne P... me dt. 18.07.2023; Raporti i analizës se narkotikeve **NarTest** e dt. 08.08.2023; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve e dt. 18.07.2023; Foto-dokumentacion i substancës narkotike., andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura duke caktuar shpalljen e aktgjykimit menjëherë meqenëse nuk kishte propozime të tjera nga palët në procedurë.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 269 par. 2 lidhur me të KPRK-së meqesne e pandehura me parë nuk qenë e dënuar dhe substanca narkotike të cilën e ka poseduar ka qenë më pak se tre (3) gram.

Me dispozitën ligjore të nenit 359 të KPPRK-së është përcaktuar se: gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehures, me parë nuk ka qenë e dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehures gjykata nuk ka gjetur.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat te këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata i obligoi të akuzuarës që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Konform nenit 269 par 3 te KPRK-se gjykata te akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuan, ne peshë prej 1.2 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:185698, 14.05.2024**

Zyrtari ligjor

Fatos Selmani

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate